



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.22

Qershor 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave maj 2005

### I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 6.5.2005 PROJEKTLIGJE

*(Vendime për propozime pro-  
jektligjesh)*

1. Për sigurimin shoqëror su-  
plementar të ushtarakëve të  
Forcave të Armatosura të Re-  
publikës së Shqipërisë.

- Projekti parashikon përfitime  
suplementare për ushtarakun  
për raste paaftësie të përko-  
hëshme në punë, pagesë kali-  
matore kur ushtaraku nxirret  
në rezervë lirim, pension të par-  
akohshëm për vjetërsi shërbi-  
mi, pension suplementar inval-  
iditeti apo për ushtarakët që  
humbasin jetën në detyrë etj.  
Ky ligj i shtrin efektet financia-  
re nga dita e hyrjes në fuqi e  
ligjit nr. 9210 datë 23.3.2004  
"Për statusin e ushtarakut të FA  
të RSH". Zbatimi i ligjit parash-  
kohet të fillojë nga 1 Janari  
2006.

2. Për disa ndryshime në ligjin  
nr.8701, datë 1.12.2000 "Për  
lojërat e fatit, kazinotë dhe  
hipodromet" të ndryshuar.

- Me ndryshimet e propozuara,  
duke vendosur tarifa fikse,  
mendohet të përmirësohet ad-  
ministrimi i këtyre lloj tatimeve  
dhe të luftohet më mirë evazi-  
oni fiskal, i cili ka qene relativ-  
isht i lartë në këto lloj aktiv-  
itetesh. *(Vijon në faqen 2)*

## Nga punimet e Kuvendit për muajin maj 2005

### I. Projektligje të shqyrtu- ara në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare.

1. P/ligji "Për masat adminis-  
trative parandaluese kundër  
fenomenit të gjakmarrjes",  
shqyrtuar në seancë plenare  
më datë 4 maj 2005.

Projektligji është nismë e depu-  
tetit Alfred Çako dhe synon të  
parandalojë fenomenin e gjak-  
marrjes, i cili vepron mbi baza  
kanunore në disa zona të ven-  
dit. Në të përcaktohen disa  
masa administrative parandal-  
uese për personat ose familjet  
që shfaqin qëllimin për të zbat-  
uar normat kanunore të gjak-  
marrjes. Për këta persona ven-  
doset masa e izolimit të vend-  
banimit në zona të thella dhe  
kufizohet e drejta e lëvizjes. Për  
zbatimin e këtij ligji ngarkohen  
organet e pushtetit vendor dhe  
ato të rendit publik.

Gjatë diskutimit për këtë pro-  
jektligj në Komisionin për  
Çështjet Ligjore, Administratën  
Publike dhe të Drejtat e Njeri-  
ut dhe në seancë plenare  
nismëtari i projektligjit argu-  
mentoi bazueshmërinë e tij në  
Kushtetutë, e cila le një hapë-  
sirë për të drejtën e shtetit për  
të hequr lirinë e personit, në  
rastin kur synohet të parandal-

*(Vijon në faqen 6)*

## Në këtë numër do të lexoni:

1. *Nga Mbledhjet e  
Këshillit të Ministrave për  
muajin maj 2005*

*faqe 1-5*

2. *Nga Punimet e Kuvendit  
për muajin maj 2005*

*faqe 1, 6-7*

3. *Informacion mbi faqet  
e internetit të Institucion-  
eve Qendrore*

*faqe 8*

4. *Njoftim*

*faqe 1, 8*

## Njoftim

*Të nderuar zonja e zotërinj,  
Kuvendi i Shqipërisë me datë  
30.06.1999 ka miratuar ligjin  
nr.8503 "Për të drejtën e in-  
formimit për dokumentat zyr-  
tare". Ky ligj rregullon të  
drejtën e informimit për çdo  
person dhe krijon mundësinë  
për të marrë informacion mbi  
dokumentat zyrtare.*

*Ligji përcakton gjithashtu  
detyrimin e autoriteteve publike*

*(Vijon në faqen 8)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 1)*

**3.** Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe pavarësisë së Rumanisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë.

- Borxhi i Shqipërisë ndaj Rumanisë është S.408.233 USD. Principal do të paguhet CASH për 10 vjet me 20 këste të barabarta 6-mujore, duke filluar nga 20 Korriku 2005.

**4.** Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave data 6.5.2005**

**1.** Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës "BOT", të hidrocentralit të Skaricës, sipas propozimit të pakërkuar.

**2.** Për lejimin e Ministrisë së Financave të përdorë procedurën e prokurimit "Kërkesë për kuotim", për ofrimin e shërbimeve të këshillimit.

**3.** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.230, datë 22.7.1991 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komisioneve të tokave" të ndryshuar.

**4.** Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe trajtimin e nënpunësit civil", të ndryshuar.

**5.** Për një ndryshim në vendimin 168, datë 9.3.2005 të Këshillit të Ministrave, "Për lejimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit të përdorë procedurën procedurën "prokurim i drejtëpërdrejtë", për përmirë-

simin e infrastrukturës së kullimit dhe të mbrojtjes nga përmbajtjet".

**6.** Për dhënie mendimi Kuvendit të republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "për një trajtim të veçantë të punonjësve efektivë të universiteteve, të shkollave të larta publike dhe të Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë".

**7.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjësshëm të shpenzimeve të kurimit të zonjës Xhemile Kuka në Turqi.

**8.** Për kriteret për përzgjedhjen e subjekteve, për dhënien me koncesion të ushtrimit të veprimtarisë së shërbimit të informatizimit fiskal dhe financiar.

**9.** Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.244, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e projektit pilot dhe të skemës së furnizimit me karburant, pa akcizë, për përcaktimin e sasive të karburantit që do të përdoren për mekanikën bujqësore në tri zona të vendit dhe për serat me ngrohje".

**10.** Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

**11.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për përballimin e shpenzimeve për shtimin e një punonjësi në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Prishtinë.

**12.** Për miratimin në parim të shtojcës së marrëveshjes dhe

kushteve të kontratës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe "GE transportation Systems, S.p.A", për modernizimin e hekurudhës Tiranë-Durrës, me lidhje për në aeroportin ndërkombëtar të Rinanit.

**13.** Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit.

**14.** Për miratimin në parim të marrëveshjes të grantit të Fondit Ndërkombëtar për Mjedisin (GEF), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e Zhvillimit të burimeve natyrore.

**15.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim, për projektin e zhvillimit të burimeve natyrore.

**16.** Për përcaktimin e shërbimit të gjendjes civile, si shërbim, që jepet me koncesion.

**17.** Për një ndryshim në vendimin nr.495, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kushteve, të personave dhe të sasisë së nevojshme të karburantit për përdorim nga anijet e peshkimit," të ndryshuar.

## **II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 13.5.2005 PROJEKTLIGJE**

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

**1.** Për faljen e kamatvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shqoërore, të papaguara.

*(Vijon në faqen 3)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 2)*

- Me këtë projektligj propozohet falja e kamatvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme të papaguara dhe ë datën 31.12.2004, ngandërrmarrjet dhe shoqëritë me kapital tërësisht shtetëror, nga institucionet shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, nga ndërmmarrjet dhe shoqëritë me kapital të përbashkët me shtetin, nga personat juridikë e fizikë privatë dhe nga personat juridikë e fizikë privatë dhe nga personat e vetpunësuar në bujqësi.

Kamatëvonesat falen dhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë, për shërbimet ajrore.

- Me këtë marrëveshje krijohen hapësira dhe mundësi më të mira në fushën e transportit të udhëtarëve, mallrave dhe dërgesave postare, si dhe do të mundësojë lehtësinë e komunikimit edhe me vendet e tjera të Europës. Gjithashtu ajo do të krijojë mundësi për të administruar më mirë çështjet e sigurisë në shërbimet ajrore ndërkombëtare, sidomos në rastet e reagimit ndaj akteve terroriste apo kërcënimeve kundër sigurisë së aviacionit civil.

**3.** Për ratifikimin e shtojcës në marrëveshjen financiare ndërmjet këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve europiane "Për programin vjetor

kombëtar të veprimit CARDS 2004".

- Në kuadrin e programit CARDS 2004, Komuniteti Europian jep në formën e një granti një shumë shtesë prej 5 milion Euro, që do t'i bashkangjitet kredisë të parashikuar në këtë program që është në shumën prej 58.5 milion euro.

Financimi do të përdoret për mbështetjen e sektorëve të tillë si drejtësia dhe çështjet e brendëshme, forcimi i kapaciteteve administrative si dhe mjedisi dhe burimet natyrore.

**4.** Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të këshillit të Europës. (CEB) për financimin e fazës së parë të projektit të ndërtimit dhe rehabilitimit të shkollave të Tiranës.

- Kjo marrëveshje është shqyrtuar e miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.308, datë 28.4.2005.

**5.** Për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të projektit të qendrës spitalore universitare "Nënë Tereza", Tiranë.

- Kjo Marrëveshje është miratuar në parim më vendimin e këshillit të ministrave nr.284, datë 28.4.2005 dhe tani propozohet për ratifikimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave data 13.5.2005**

**1.** Për miratimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjis-

lacionit vendas me atë të bashkimit Europian dhe Zbatimit të Angazhimeve që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim – Asociimit.

**2.** Për disa ndryshime në vendimin nr.787, datë 26.11.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve".

**3.** Për zbatimin e fazës së pestë të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve.

**4.** Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

**5.** Për sigurimin e të dhënave për pronat publike e private, në funksion të realizimit të procesit të kthimit dhe kompensimit të tyre.

**6.** Për procedurat e rekrutimit të ushtarakëve profesionistë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

**7.** Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe UNESCO-s, "Për mbështetjen e projektit për krijimin e qendrës së restaurimit dhe konservimit të monumenteve të kulturës".

**8.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicriane, për modernizimin e arshivave kombëtare të Shqipërisë, faza III.

**9.** Për miatimin në parim të marrëveshjes së transportit ajror, ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe kabinetit të Ministrave të Ukrainës.

*(Vijon në faqen 4)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 3)*

**10.** Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për njohjen e ndërsjellë të diplomave.

**11.** Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së mesme të përgjithëshme të profilizuar "ARSKEIO", që do të zhvillojë mësimin edhe në gjuhën greke.

**12.** Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

**13.** Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2005, për disa institucione buxhetore, për shpenzime personeli.

**14.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë për zhvillim, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e menaxhimit të integruar dhe pastrimit të zonës bregdetare.

**15.** Për një ndryshim në vendimin nr 102, datë 5.3.1999 të Këshillit të Ministrave, "Për një trajtim me strehim të funksionarëve politikë dhe nënpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore", të ndryshuar.

**16.** Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës së Italisë, për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anë të një kredie ndihme për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si edhe sigurimin e asistencës teknike për to.

## III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 20.5.2005

### PROJEKTLIGJE

*(Vendime për propozime projektligjesh)*

**1.** Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

- Sipas ndryshimit të propozuar, përjashtohen nga ndjekja penale për amrëmbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarakë personat që në përputhje me legjislaturën në fuqi, i dorëzojnë vullnetarisht armët deri në 31.5.2007.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për huanë e dhënë shoqërisë "Tirana Airport partners (TAP)", sh.p.k, nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin "Punët e infrastrukturës publike dhe ndërtimi i seksionit rrugor të aeroportit".

- Me ratifikimin e marrëveshjes bëhet i mundur fillimi i punimeve për realizimin e projektit.

**3.** Për ratifikimin e protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor.

- Ky është një akt normativ ndërkombëtar në kuadër të Konventës ESPOO "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar" kur Shqipëria aderon që nga viti 1991, për vlerësimin mjedisor të politikave, strategjive e planeve të veprimit, para se ato të miratohen nga organet vendimarrëse.

**4.** Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e vitit 1979, "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit, në distancë të madhe".

- Me aderimin në këtë Konventë hapet rruga për mbështetje më

fiancime të huaja të projekteve në zbatim të kërkesave të saj, duke krijuar kështu edhe mundësi teknike dhe profesionale për identifikimin dhe kontrollin e plotë të veprimtarive që shkaktojnë ndotjen e ajrit.

### VENDIME të Këshillit të Ministrave data 20.5.2005

**1.** Për miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, ndërmjet ministrisë së Industrisë dhe të Energjitikës dhe shoqërive Occidental of Albania (ONSHORE-2) Limited dhe Occidental of Albania (ONSHORE -3) Limited për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarburanteve, bllokohen 2 dhe 3 ne takë, Shqipëri.

**2.** Për një ndryshim në vendimin nr.84, datë 13.2.2003 të këshillit të Ministrave, "Për administrimin dhe mbulimin e shërbimeve nga personeli mjekësor, i përfshirë në skemën e sigurimeve shëndetësore.

**3.** Për miratimin në parim të konventës nr.102, të Organizatës Ndërkombëtare të punës "Për sigurimet shoqërore (standartet minimale)".

**4.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet parlamentare, të vitit 2005.

**5.** Për miratimin në parim të marrëveshjes specifike, ndërmjet këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Suedisë, në fushën e tati-meve.

**6.** Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjedisve të ish-kampingut për të

*(Vijon në faqen 5)*



# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 4)*

ardhurit nga Kosova, në shoq të vogël, Fier, nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të Ministrisë së Drejtorisë.

**7.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Bilishtit, të qarkut të Korçës.

**8.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Ersekës, të qarkut të Korçës.

**9.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Galaj, të qarkut të Kukësit.

**10.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Vreshtas, të qarkut të Korçës.

**11.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të plauajtëshme shtetërore në komunën Pakuqan, të qarkut të Tiranës.

**12.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Fajzë të qarkut të Kukësit.

**13.** Për hapjen e pikës së kalimit kufitar në fshatin Barje të Kukësit, në kufirin tokësor të Republikës së Shqipërisë në Kosovë.

**14.** Për rishpërndarje fondesh buxhetore ndërmjet Ministrisë së Rregullimit të territorit dhe të Turizmit dhe Ministrinë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për vitin 2005.

**15.** Për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet Ministrisë së rregullimit të territorit dhe të Turizmit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, për vitin 2005.

**16.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

**17.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.

**18.** Për lejimin e Ministrisë së Financave të përdorë procedurën “prokurim i drejtëpërdrejtë”, për ofrimin e shërbimeve të konsullencës.

**19.** Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Ujësjellës-Kanalizimeve në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë”, për realizimin e punimeve për trajtimin e hidrocentralit të Banjës.

**20.** Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin e pronave të klubit të futbollit “Tiranë”, në pronësi të bashkisë së Tiranës.

**21.** Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut Elbasan.

**22.** Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut Shkodër.

**23.** Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut Fier.

**24.** Për dhënie ndihmë financiare familjes së fëmijës Betim basri Shehu.

**25.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë, bankës ABN AMRO dhe Bankës Amerikane të Shqipërisë, për modernizimin e linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe të lidhjes hekurudhore me aeroportin e Rinasit.

**26.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe bankës ABN AMRO, për modernizimin e linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe të lidhjes

hekurudhore me aeroportin e Rinasit.

## **IV. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 26.5.2005 VENDIME të Këshillit të Ministrave**

**1.** Për miratimin e repartit të vlerësimit të ofertave dhe të fituesit, në tenderin e hapur ndërkombëtar, për privatizimin e shoqërisë anonime “Albtelekom”.

**2.** Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Gjirokastrës.

**3.** Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Lezhës.

# Nga Punimet e Kuvendit për muajin maj 2005

*(Vijon nga faqja 1)*

ohet kryerja prej tij e një vepre penale.

Projektligji nuk gjeti mbështetjen e shumicës së deputetëve, të cilët ishin të mendimit se ai cënon të drejtat dhe liritë e njeriut të sanksionuara në Kushtetutë, duke parashikuar që shteti të vendosë kufizime të vendbanimit dhe të lëvizjes së personave mbi bazën e një gjakmarrjeje të supozuar. Gjithashtu, ata ishin të mendimit se në projektligj parashikohet marrje e kompetencave të pushtetit gjyqësor nga ai ekzekutiv, duke i dhënë organeve të qeverisjes vendore disa kompetenca të pambështetura në Kushtetutë dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Edhe terminologjia e përdorur në projektligj, sipas tyre, është me mangësi, pasi në të përdoren terma juridike të pabazuara në legjislacionin juridik si Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Civil etj. Me këto argumente, Kuvendi vendosi me shumicë votash të mos e miratojë projektligjin.

**2.** P/ligji “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, nismë e Këshillit të Ministrave, miratuar në seancë plenare më datë 4 maj 2005

Projektligji trajton në mënyrë të plotë dhe organike të gjitha problemet që kanë dalë në sektorin e pyjeve gjatë periudhës së tranzicionit, duke i dhënë zgjidhje edhe mungesës së bashkëpunimit institucional midis organeve të shërbimit pyjor me ato të pushtetit vendor. Në të plotësohen dhe zgjerohen kompetencat për kontrollin dhe mbikëqyrjen e fondit pyjor, trajtohen në mënyrë integrale politika, programet e zhvillimit dhe planet e mbarështimit të pyjeve, bashkëpunimi midis organeve shtetërore për mbrojtjen e mjedisit me organet e shërbimit pyjor, zgjidhen disa mospërputhje që ka patur ligji ekzistues me disa ligje të tjera, si ligji minerar, ligji për urbanistikën, ligji për turizmin dhe ligji për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në seancë plenare deputetët theksuan rëndësinë e projektligjit dhe e vlerësuan pozitivisht atë. Pas miratimit në parim të projektligjit, Kuvendi miratoi disa ndryshime në dispozitat e tij e konkretisht në çështjet e decentralizimit të kompetencave, në saktësimin dhe plotësimin e kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Pyjor, veçanërisht në drejtim të administrimit të të ardhurave që krijohen nga ky shërbim, në përcaktimin më të saktë të statusit të Policisë Pyjore, etj.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi unanimisht projektligjin.

**3.** P/ligji “Për qirane financiare”, nismë e Këshillit të Ministrave, miratuar në seancë plenare më datë 12 maj 2005.

Projektligji rregullon dhe plotëson kuadrin ligjor të qiramarrjes financiare, e cila përmendet vetëm në nenin 849 të Kodit Civil, ku përcaktohet kontrata e qirasë financiare. Gjithashtu, veprimtaria e qirasë financiare rregullohet edhe në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, e cila ka detyrimin që të licencojë subjektet që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë.

Duke qenë se transaksioni i qirasë financiare është kompleks, sepse ai përmban elemente të qirasë, kredisë, shitjes dhe shitjes me rezervë pronësie dhe duke qenë se qiraja financiare është një fenomen i ri në tregun shqiptar, është parë e arësyeshme që për këtë fushë të ketë një ligj të veçantë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Përhershëm për Ekonominë dhe Financat specialistet e Ministrisë së Ekonomisë spjeguan domosdoshmërinë e projektligjit, i cili do t'i japë një shtysë të ndjeshme zhvillimit të veprimtarisë së qirasë financiare dhe do të shërbejë si një mekanizëm i rëndësishëm financiar për bizneset e vogla dhe të mesme që dëshirojnë të investojnë, por nuk kanë mundësi, për shkak të kolateralit të pamjaftueshëm apo të pamundësisë për të përfituar kredi.

Mbështetur në këto argumente, Kuvendi e miratoi projektligjin në parim. Ndërkohë, Kuvendi miratoi disa ndryshime në formulimin e disa prej dispozitave të projektligjit, të cilat nuk prekin thelbin e tij.

**4.** P/ligji “Mbi kontrollin e OMGJ-ve”, shqyrtuar në seancë plenare më datë 12 maj 2005

Projektligji është nismë e një grupi deputetësh të Partisë Demokratë dhe synon të plotësojë boshllëkun ligjor në fushën e organizmave të modifikuara gjenetikisht, duke realizuar edhe përafimin e tij me legjislacionin e vendeve të Bashkimit Europian.

Gjatë diskutimit në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në seancë plenare deputetët vlerësuan qëllimin e nismëtarëve të projektligjit dhe theksuan rëndësinë e përmirësimit dhe plotësimin të legjislacionit në këtë fushë. Por, ata ishin të mendimit se projektligji është me

*(Vijon në faqen 7)*

# Nga Punimet e Kuvendit për muajin maj 2005

(Vijon nga faqja 6)

mangësi, të cilat krijojnë hapësira për futjen e paktrolluar të produkteve ushqimore të përfuara nga bimë ose kafshë të modifikuara gjenetikut. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi me shumicë votash të mos e miratojë projektligjin.

5. P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004 dhe ligjin nr.9341, datë 10.1.2005", shqyrtuar në seancë plenare më datë 12 maj 2005 Nismëtarët e amendamenteve në Kodin Zgjedhor janë një grup deputetësh të Partisë Demokratike. Një ndër amendamentet kryesore të këtij projektligji synon të realizojë bashkimin e votës për kandidatin me votën për subjektin politik që ai përfaqëson. Sipas tij, zgjedhësi hedh vetëm një votë në kutinë e votimit, në vend të dy votave që hedh sot, e cila është e vlefshme si për kandidatin e partisë në maxhoritar, ashtu edhe për partinë që ai përfaqëson gjatë llogaritjes proporcionale të votave të saj. Sipas nismëtarëve, synimi i këtij projektligji është të kufizojë mundësinë e manovrimeve elektorale dhe të rrisë rolin e partive politike në procesin zgjedhor.

Projektligji nuk gjeti mbështetjen e shumicës së deputetëve në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe më pas, në seancë plenare. Ata ishin të mendimit se projektligji bie në kundërshtim me Kushtetutën, e cila përligj sistemin e përzier zgjedhor, mazhoritar e proporcional. Gjithashtu, ata theksuan se projektligji bie në kundërshtim edhe me Kodin Zgjedhor.

Veç argumenteve të përmedura më lart, shumica e deputetëve ishin të mendimit se korrigjimet që propozohen të bëhen në kuadrin ligjor për zgjedhjet paraqiten në një kohë të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme.

Për këto arsye, Kuvendi nuk e miratoi projektligjin me shumicë votash.

## II. Raportime të institucioneve të pavarura

1. Raport i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë dhe miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e punës së këtij institucioni, shqyrtuar në seancë plenare në datat 9 dhe 12 maj 2005

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Ardian Fullani, në raportin që prezantoi para Kuvendit, informoi deputetët me veprimtarinë e institucionit

që ai drejton për vitin 2004. Ai theksoi se Banka e Shqipërisë i ka realizuar objektivat e vëna në fillim të vitit në treguesit kryesorë të veprimtarisë së saj. Kështu, indeksi i çmimeve të konsumit u realizua në masën 2.1 për qind, duke qenë brenda intervalit objektiv, 2-4 për qind. Objektivat e ndërmjetëm të programit monetar janë plotësuar dhe janë në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar nga Qeveria shqiptare me FMN-në. Sistemi bankar është zgjeruar e konsoliduar, ka përmirësime të infrastrukturës së pagesave, reduktim të parasë *cash* në ekonomi etj.

Raporti i Guvernatorit u prezantua në një takim të zgjeruar me deputetë të Komisionit të Përherëshëm për Ekonominë dhe Financat dhe me specialistë të Bankës së Shqipërisë e më pas, në seancë plenare.

Deputetët e mazhorancës vlerësuan si të suksesshme veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, e cila është zhvilluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Deputetët opozitarë, duke iu referuar Raportit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, e përqëndruan vëmendjen në mosrealizimin e disa treguesve kryesorë kundrejt planifikimit dhe bënë një vlerësim negativ të punës së këtij institucioni. Ata shprehën shqetësimin e tyre për përkeqësimin gjatë vitit 2004 të nivelit të financimeve të huaja kundrejt nivelit të parashikuar në buxhet, për mosrealizimin e të ardhurave, i cili është shoqëruar me rënien e shpenzimeve korrente, për rritjen e detyrimeve të shtetit ndaj huamarrësve dhe veçanërisht, për rritjen e detyrimeve në formën e kredisë tregtare.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi me shumicë votash një projektrezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004, në të cilën krahas vlerësimeve pozitive, pasqyrohen disa detyrime që i vihen këtij institucioni për të thelluar kontributin e tij pozitiv në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit, si dhe disa detyrime që i vihen Këshillit të Ministrave për përmirësimin e marrëdhënieve me këtë institucion.

## Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

Presidenca [www.president.al](http://www.president.al)

Këshilli i Ministrave  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

Ministria e Financave  
[www.min.fin.gov.al](http://www.min.fin.gov.al)

Ministria e Mbrojtjes  
[www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al)

Ministria e Mjedisit [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al)

Ministria e Shëndetësisë  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Ministria e Rendit Publik  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

Ministria e Punëve të Jashtme  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Ministria e Pushtetit Vendor dhe  
Decentralizimit  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

Ministria e Transportit dhe  
Telekomunikacionit  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit  
[www.mbu.gov.al](http://www.mbu.gov.al)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe  
Sporteve  
[www.mkrs.gov.al](http://www.mkrs.gov.al)

Ministria e Industrisë dhe  
Energjitikës [www.meep.gov.al](http://www.meep.gov.al)

Ministria e Rregullimit të Territorit  
dhe Turizmit  
[www.mrrtt.gov.al](http://www.mrrtt.gov.al)

Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit  
[www.minek.gov.al](http://www.minek.gov.al)

Ministria e Integritetit European  
[www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al)

Bashkia e Tiranës  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Departamenti i Administraës Publike  
[www.pad.gov.al](http://www.pad.gov.al)

## Njoftim

*(Vijon nga faqja 1)*

*për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.*

*Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar.*

*Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.*

*Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.*

*Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;*

***"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.***

***Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30***

***Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP".***

### **Denada BRESHANAJ**

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator  
Qendra e Studimeve Parlamentare/  
Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;  
[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdp.org](http://www.ascdp.org)